



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
ZYRA ME NJË NDALESË**

Nr. _____ Prot.

Maliq, më:10.09.2019

Procesverbal

I mbajtur në dëgjuesen publike për Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, në Njësinë Administrative Pirg.

Në kuadër të Ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit 119/2014, “Për të drejtën e informimit publik”, dhe Ligjit nr. 146/2014, neni 18 “Pjesëmarrja në takime publike”, u mbajt sot, më dt.10.09.2018, ora 10:30 në sallën e mbledhjeve të Njesisë Administrative Pirg , takimi konsultativ (dëgjesa publike) mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, si dhe për buxhetin vjetor, pjesë e buxhetit afatmesëm.

Në takim morën pjesë : Kryetari i Bashkisë Maliq:, z.Gëzim Topçiu ,Deputeti i zonës, z.Illirjan Pendavinji, drejtues dhe specialistë të Bashkisë Maliq, banorë të Njesisë Administrative Pirg ,kryetarë të Fshatrave ,përfaqësues të bizneseve, shoqatave ,si dhe grupe e tjera të interesit.

Në vijim të procesit të hartimit dhe përgatitjes së Programit-Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2019-2021, dhe për buxhetin vjetor 2019, takuam dhe dëgjua banorët e Njesisë Administrative Pirg , për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve reale, që do të realizohen nga Bashkia Maliq, me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat, ku këta banorë jetojnë. Gjatë diskutimit, në thelb të dëgjësave publike ishin, jo vetëm punët dhe investimet e kryera nga Bashkia Maliq gjatë këtyre tre viteve, por dhe kërkesave e nevojave thelbësore në lidhje me përmirësimin e një sërë shërbimesh si ç’janë:

1.Furnizimi me ujë të pijshëm dhe ndriçimi publik në disa fshatra të njësisë, si:

a)Pirgu nr. 2, b) Velitërnë, c) Symize. Novoselë. Zvirinë.

2. Rehabilitimi dhe sistemimi i rrugëve të brendshme në fshatra si dhe në parcelat bujqësore.

Në fshatrat si: Sovjan, Kakaç, Veliterne.

3. Asfaltimi i rrugës Sovjan-Novoselë.

4. Rikonstruksioni i ujësjellësit dhe kanalizimeve në fshatin Pirg/ Pirgu nr. 1.

5. Pajisja me sinjalistike në fshatin Velitërnë, lagjia lartë, rruga nacionale , Korçë-Pogradec.

6. Riparimi i linjës së korentit në fshatin Kakaç, si dhe liri i 10 ha toke të bllokuar.

7. Në fshatin Gurisht u kërkua ndërhyrja në riparimin e linjës së ujësjellësit, 1.5 km gjatësi.

8. Në fshatin Sovjan u kërkua ndërhyrja në depon e ujit, dhe çakullimi i rrugëve të brendëshme.

Theksi u vendos dhe tek përmirësimi i disa objekteve ,si kopshte ,shkolla ,furnizimi me dru zjarri etj. Takimi u hap me fjalën e Kryetarit të Bashkisë Maliq, e cila u pasua me prezantimin e Programit Buxhetor për periudhën 2019-2021, u bë një analizë e investimeve dhe punëve që janë kryer nga Bashkia Maliq gjatë kësaj periudhe, si dhe u propozua hedhja e ideve dhe mendimeve të banorëve të komunitetit për të përcaktuar prioritetet e investimeve dhe alokimin e fondeve sipas nevojave dhe kërkesave të komunitetit. Pas prezantimit u vijua me komente dhe pyetje të pjesëmarrësve, të cilëve i'u përgjigjën drejtues dhe specialistë të Bashkisë që mbulojnë sektorët përkatës.

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Stiljan Belishta